

**Vendim nr. 99, date 02.04.2026**

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fiona Papajorgji, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Marjana Semini, Asim Vokshi, Genti Ibrahim, Anëtarë në datën 02.04.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (I) 2026 të Regjistrisë Themeltar, që i përket:

**KËRKUESE:** **IRINA HASANI**, përfaqësuar nga avokate Eni Shehu (Çobani), me prokurë të përgjithshme

**OBJEKTI:** **Shfuqizimi i vendimeve nr. 1267, datë 28.3.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2025-3132, datë 18.09.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

**BAZA LIGJORE:** **Nenet 23, 33, 42, 43, 48, 118, pika 3, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, 137, 140, pika 2, shkronja “a”, dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 1, 6, 13, 14 dhe 18 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 71, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahim, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuesja ka ushtruar detyra të ndryshme pranë Drejtorisë së Spitalit Rajonal Shkodër (*DSRSH*) për periudhën 11.12.2008 deri më 26.11.2014 kur është shkarkuar nga detyra në bazë të rekomandimit të një auditimi të kryer nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë.

2. Duke mos qenë dakord me këtë vendim, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, e cila ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë dhe detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë kërkuesen gjithsej me 16.5 paga mujore bruto, për shkak të largimit të menjëhershëm dhe të pajustificuar nga puna, mosrespektimit të afatit të njoftimit dhe vjetërsisë në punë sipas dispozitave përkatëse të Kodit të Punës. Ajo gjykatë ka arsyetuar se zgjidhja e kontratës së punës është bërë pa shkaqe të justifikuara në kushtet kur raporti final i auditimit nuk rekomandonte largimin nga detyra të saj, por përmirësimin e të metave të konstatuara. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim *DSRSH*-ja.

3. Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dhe rrëzimin e padisë. Ajo gjykatë ka arsyetuar se zgjidhja e kontratës së punës është bërë për shkaqe të justifikuara, pasi rezultoi e provuar se kërkuesja ka kryer shkelje të ndryshme dhe se zgjidhja e kontratës duhet trajtuar si zgjidhje e menjëhershme për shkaqe të justifikuara sipas nenit 153 të Kodit të Punës. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesja, e cila ka kërkuar prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

4. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-3132, datë 18.09.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit për shkak se nuk përmbante kërkesat e parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*).

5. Në datën 15.01.2026 kërkuesja ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij. Kolegji i Gjykatës në datën 21.01.2026, gjatë shqyrtimit paraprak, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

## II

### Pretendimet e kërkueses

6. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në drejtim të:

- 6.1. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe së drejtës për punë*, pasi gjykatat nuk kanë përmbushur detyrimin për të dhënë një vendim të arsyetuar dhe nuk kanë trajtuar pretendimet dhe provat thelbësore të paraqitura prej saj, por i kanë marrë të mirëqena rezultatet e auditimit. Në veçanti, në vendimin e Kolegjit Administrativ nuk janë evidentuar dhe analizuar parashtrimet me shkrim të paraqitura përpara shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit, në të cilat janë paraqitur argumente ligjore shtesë për cenimin procedural dhe substancial të së drejtës për punë. Ndonëse Gjykata e Lartë është shprehur për një pjesë të pretendimeve në rekurs që ngre çështje të vlerësimit të provave, në fakt kërkesja ka paraqitur pretendim edhe për interpretimin edhe zbatimin e gabuar të ligjit nga gjykatat e faktit, në kuptimin e cilësimit juridik të mosmarrëveshjes së punës në lidhje me analizën e shkaqeve të justifikuar.
- 6.2. *Parimit të gjykimit të drejtë*, pasi Gjykata Administrative e Apelit duhet të kishte analizuar natyrën e shkeljes dhe pasojat e saj (në kuptimin e dëmit të ardhur), për të vlerësuar objektivisht proporcionalitetin e masës së zgjidhjes së kontratës së punës, duke sjellë, si pasojë, cenimin e së drejtës për punë të kërkeses.

### III

#### Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

##### A. *Për legjitimitetin e kërkeses*

7. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Në këtë këndvështrim, kërkesja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi. Po kështu, ai plotëson edhe kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, pasi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e në substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Kërkesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë mban datën 18.09.2025, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë më 15.01.2026, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

9. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkesja ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në drejtim të *standardit të arsytimit* të vendimit gjyqësor të lidhur me *cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe së drejtës për punë*, pasi gjykatat nuk kanë përmbushur detyrimin për të dhënë një vendim të arsyetuar dhe nuk kanë trajtuar pretendimet dhe provat thelbësore të paraqitura prej saj. Në veçanti, në vendimin e Kolegjit Administrativ nuk janë evidentuar dhe analizuar parashtrimet me shkrim të paraqitura përpara shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit, në të cilat janë paraqitur argumente ligjore shtesë për cenimin procedural dhe substancial të së drejtës për punë. Më tej, kërkesja ka pretenduar se Gjykata Administrative e Apelit, në arsyetimin ligjor të vendimit të saj, nuk ka respektuar parimin e proporcionalitetit, pasi nuk e ka analizuar natyrën e shkeljes së kryer në raport me detyrën funksionale të kërkueses dhe as shkallën e rëndësisë së shkeljes dhe mundësinë e korrigjimit të pasojave, duke sjellë si pasojë cenimin e parimit të *gjykimit të drejtë* dhe cenimit të *së drejtës për punë*, të drejta këto që *prima facie* bëjnë pjesë në juridiksionin e Gjykatës.

10. Duke marrë në konsideratë thelbin e pretendimeve të kërkueses dhe mënyrën e parashtrimit të tyre, Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton se ajo ka pretenduar cenimin e së drejtës për punë dhe së të drejtës për t'u dëgjuar, si pasojë e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të *standardit të arsytimit* të vendimit gjyqësor gjatë gjykimit në apel dhe për shkak të mosshqyrtimit të parashtrimeve në shtesën mbi rekursin. Për rrjedhojë, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon t'i analizojë ato në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit të

drejtat kushtetuese nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor, në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor me pasoja të mundshme mbi të drejtën për t'u dëgjuar dhe të drejtën për punë. Në këto rrethana, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon të verifikojë nëse: (i) gjykatat e zakonshme kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsytimin e vendimeve të tyre në lidhje me proporcionalitetin e masës së largimit nga puna; (ii) shtesa e rekursit e paraqitur nga kërkuesja përmban shkaqe të reja dhe nëse mungesa e trajtimit të saj në vendimin e Gjykatës së Lartë ka vënë në dyshim thelbin e vendimmarrjes së kësaj të fundit dhe funksionin kushtetues të arsytimit të vendimit gjyqësor.

11. E drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsytuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Për sa i përket standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, Gjykata ka theksuar se ai është element thelbësor i një vendimi të drejtë dhe se vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë i qartë në përmbajtje. Argumentet e pjesës arsytuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiktë të hapur. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 13, datë 21.03.2023; nr. 11, datë 24.05.2022; nr. 16, datë 16.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata, rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsytimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 13, datë 21.03.2023; nr. 28, datë 01.11.2022; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata në vijimësi është shprehur se zbatimi i ligjit është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm. Kjo do të thotë se Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që e bën të padrejtë gjykimin (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Sipas Gjykatës, detyrimi për garantimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se nevojitet përgjigje e detajuar për çdo pretendim të palëve

ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë. Megjithatë, kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 11, datë 16.04.2018; nr. 45, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata, rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 13, datë 21.03.2023; nr. 28, datë 01.11.2022; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në lidhje me të drejtën për t'u dëgjuar, Gjykata ka pohuar se kjo e drejtë, në unitet edhe me të drejta të tjera, ka për qëllim garantimin e një procesi gjyqësor ku individit i krijohen mundësitë që përpara marrjes së vendimit gjyqësor të dëgjohet realisht për thelbin e çështjes. Nëpërmjet pjesëmarrjes dhe krijimit të kushteve për t'u dëgjuar, individëve u krijohen mundësi të barabarta për deklaratimet e tyre, për parashtrimin e fakteve, provave e vlerësimeve ligjore (*shih vendimet nr.9, datë 27.02.2024; nr. 7, datë 12.03.2010; nr. 12, datë 06.06.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se arsyetimi ka për funksion t'u tregojë palëve se janë dëgjuar nga gjykata, ka pohuar se Gjykata e Lartë duhet të ketë kujdes të shtuar në administrimin e të gjitha akteve të depozituara nga palët, përfshirë edhe shtesën e rekursit (*shih vendimin nr. 5, datë 29.01.2025 të Gjykatës Kushtetuese*). Kur shqyrtimi i rekursit bëhet nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit, pa pjesëmarrjen e palëve, paraqitja e shtesës së rekursit duhet evidentuar në vendimin e saj, edhe nëse në përfundim konkludon se ky akt është paraqitur në kundërshtim me legjislacionin në fuqi (*shih vendimin nr. 30, datë 18.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Mungesa e arsyetimit në vendim për shkaqet me natyrë kushtetuese të ngritura në shtesën e rekursit vë në dyshim të drejtën e kërkuesit për t'u dëgjuar për të gjitha pretendimet e tij (*shih vendimet nr. 77, datë 05.11.2024; nr. 19, datë 07.07.2022 të Gjykatës Kushtetuese*), duke sjellë si pasojë edhe cenimin e së drejtës së aksesit (*shih vendimin nr. 50, datë 25.09.2025 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, në rastet kur në shtesën e rekursit nuk parashtrohen shkaqe të reja në raport me rekursin, mospasqyrimi i tyre në vendim nuk përbën shkelje kushtetuese, për sa kohë që kjo mangësi nuk ka ndikuar në thelbin e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë (*shih vendimet nr. 5, datë 29.01.2025; nr. 88, datë 28.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Duke iu rikthyer rastit konkret, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se ish-punëdhënësi i kërkueses ka paraqitur ankim në gjykatën e apelit ndaj vendimit të gjykatës së

shkallës së parë që i njëjtte asaj shpërblimin e dëmit për largimin e menjëhershëm e të pajustificuar nga puna. Ajo gjykatë ka vendosur ndryshimin e vendimit duke arsyetuar se nga provat e paraqitura me anë të praktikës dokumentare, shkeljet që i atribuohen kërkueses përbëjnë shkaqe të mjaftueshme për zgjidhjen në mënyrë të menjëhershme të marrëdhënies së punës, si dhe, ndryshe nga se pretendonte ajo, raporti i auditimit kishte lënë si detyrë marrjen e masës disiplinore të largimit nga puna.

16. Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit paditësja ka paraqitur rekurs, duke kërkuar prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Në rekurs ajo ka pretenduar, ndër të tjera, se gjykata e apelit ka bërë një vlerësim të gabuar të rrethanave faktike dhe të funksioneve të ushtruara prej saj në periudha të ndryshme pune, duke i marrë të mirëqena konstatimet e auditimit pa shqyrtuar observacionet e paraqitura prej saj. Sipas rekursit, raporti i auditimit nuk kishte rekomanduar largimin e saj nga detyra, ndërsa procedura e ndjekur nga punëdhënësi ishte e parregullt dhe kishte çuar në një vendim të gabuar për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

17. Nga shqyrtimi i akteve të depozituara së bashku me ankimin kushtetues individual, rezulton se kërkuesja ka paraqitur edhe parashtrime shtesë për rekursin, duke sjellë argumente shtesë në lidhje me zbatimin e ligjit material nga gjykata e apelit, që, sipas saj, janë me rëndësi për zbatimin e kriterëve të nenit 58 të ligjit 49/2012 në lidhje me shkaqet për të cilat ushtrohet rekurs në Gjykatën e Lartë e më konkretisht shkronja “a” në lidhje me zbatimin e gabuar të ligjit material ose procedural, të një rëndësie themelore për njësimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore.

18. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se rekursi i paraqitur nuk përmbante asnjë nga shkaqet që parashikon neni 58 i ligjit nr. 49/2012, të cilat mund të cenonin vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit. Gjithashtu, kolegji i asaj gjykate ka nënvizuar se është detyrë e rekursuesit të parashtrijë dhe të artikulojë qartësisht e në mënyrë të plotë këto shkaqe ligjore.

19. Në këndvështrim të përmbajtjes së pretendimeve të kërkueses dhe arsytimit të vendimeve objekt të ankimit kushtetues individual, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se gjykata e apelit, në përputhje me kompetencat e saj ligjore, ka marrë në shqyrtim ankimin, duke arsyetuar qëndrimin e saj të shprehur në dispozitiv për rrëzimin e tij. Në këtë kontekst, rezulton se arsytimi i asaj gjykate është mjaftueshëm i qartë në përmbajtje dhe argumentet e pjesës arsyetuese janë të mjaftueshme në lidhje me proporcionalitetin e masës së largimit nga puna, si dhe për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Po kështu, edhe përcaktimi i fakteve

dhe interpretimi i ligjit nga ajo gjykatë nuk duket arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që e bën gjykimin të padrejtë në këndvështrimin kushtetues.

20. Edhe Gjykata e Lartë, ndonëse me arsyetim të kufizuar, i ka dhënë përgjigje këtij pretendimi përderisa në vendimin e saj janë paraqitur shkaqet e rekursit dhe arsyet se përse nuk mund të cenohej vendimi i gjykatës së apelit. Në këtë kuptim, për sa i përket arsyetimit të kufizuar të vendimeve të dhomës së këshillimit, jurisprudenca kushtetuese ka vlerësuar se nuk përbën cenim të së drejtës për proces të rregullt ligjor dhe se kërkesat e këtij procesi mund të plotësohen edhe me një arsyetim të kufizuar të këtyre vendimeve. Kjo formë arsyetimi shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit paraprak në dhomën e këshillimit. Arsyetimi i kufizuar i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulimin e vendimit në dhomën e këshillimit është tregues i faktit që kërkuesi nuk ka ngritur një nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës (*shih vendimet nr. 49, datë 10.07.2015; nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Prandaj, pretendimi i kërkueses në lidhje me arsyetimin e gjykatave të zakonshme për proporcionalitetin e masës së largimit nga puna është haptazi i pabazuar.

21. Për sa u takon pretendimeve për shtesën mbi rekursin, në parantezë, Gjykata vëren se neni 43 i Kushtetutës garanton të drejtën e çdo individi për të ankimuar një vendim gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe për çështje me rëndësi ose vlerë të vogël. Në funksion të kësaj të drejte, si dhe të parimit të sigurisë juridike (*shih vendimet nr. 23, datë 04.03.2026; nr. 27, datë 18.05.2023; nr. 9, datë 07.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese*), legjislacioni procedural ka parashikuar afate dhe kërkesa formale për ushtrimin e mjeteve të ankimit, mosrespektimi i të cilave sjell pasojën e mospranimit të tyre.

22. Kështu, në gjykimin administrativ, rekursi depozitohet në gjykatën e apelit brenda 30 ditëve nga njoftimi i vendimit që kundërshtohet (nenet 443 dhe 446 të KPC-së, si dhe neni 60 i ligjit nr. 49/2012). Ndonëse ligji nuk parashikon shprehimisht të drejtën për paraqitjen e shtesave të rekursit, ai rregullon procedurën për ndreqjen e të metave të tij (neni 57 i ligjit nr. 49/2012) dhe detyrimin e Gjykatës së Lartë për të njoftuar datën e shqyrtimit të rekursit të paktën 15 ditë përpara (neni 61 i po këtij ligji). Këto dispozita synojnë garantimin e zhvillimit të rregullt dhe efektiv të procesit gjyqësor, duke siguruar, nga njëra anë, që palët të kenë dijeni për aktet dhe pretendimet e paraqitura, me qëllim ushtrimin efektiv të së drejtës së mbrojtjes, dhe, nga ana tjetër, që gjykata të disponojë kushtet e nevojshme për të shqyrtuar dhe vendosur

në mënyrë të informuar për mosmarrëveshjen. Për rrjedhojë, Mbledhja e Gjyqtarëve thekson se e drejta kushtetuese për proces të rregullt ligjor nuk vendos detyrime vetëm për organet gjyqësore, por kërkon edhe nga individit të tregojë kujdesin e duhur në përmbushjen e detyrimeve procedurale që i ngarkon ligji.

23. Ndërsa në analizë të vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se në arsyetimin e saj nuk pasqyrohet paraqitja e shtesës së rekursit dhe vlerësimi i saj, të cilat *prima facie* përbejnë shkelje procedurale. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt, nga pikëpamja kushtetuese, përveçse kur shkelja është thelbësore (*shih vendimet nr. 8, datë 10.04.2025; nr. 30 datë 18.04.2024; nr. 9, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Mbi bazën e këtyre standardeve, Gjykata do të analizojë nëse mospasqyrimi i shtesës së rekursit në vendimin e Gjykatës së Lartë ka ndikuar ose jo në thelbin e së drejtës për të pasur një vendim të arsyetuar, pra nëse vendimi i Gjykatës së Lartë e ka përmbushur ose jo funksionin e tij, ndër të tjera, për t'i treguar kërkueses se është respektuar e drejta për t'u dëgjuar dhe për të marrë përgjigje për të gjitha pretendimet e saj.

25. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se, në rastin konkret, argumentet e parashtruara në shtesën e rekursit janë, në thelb, shtjellime të pretendimeve të ngritura më parë gjatë gjykimit në gjykatat e zakonshme dhe në rekurs. Në këtë mënyrë, mospasqyrimi i pretendimeve të parashtruara në shtesën e rekursit në vendimin e Gjykatës së Lartë nuk ka ndikuar në thelbin e vendimmarrjes së saj, për këtë arsye nuk përbën shkelje thelbësore.

26. Për sa më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

27. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se ankimi kushtetues individual i kërkueses nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Mbledhja e Gjyqtarëve, në bazë të nenit 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

## **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.